



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 145, datë 31.10.2014

PËR
REVOKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
”INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, dhe nenit 155, germa g, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOI SE:

Autoriteti me Vendimin nr. 133, datë 30.09.2014, ka miratuar bashkimin me përthithje të shoqërisë së sigurimit “Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a. (shoqëria e përthithur) me shoqërinë e sigurimit “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a. (shoqëria përthithëse).

Në datën 9.10.2014, Qendra Kombëtare e Regjistrimit ka kryer regjistrimin e bashkimit me përthithje të shoqërisë së sigurimit “Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a. (shoqëria e përthithur) me shoqërinë e sigurimit “Sigma Vienna Insurance Group” sh.a. (shoqëria përthithëse) në përputhje me dokumentacionin e depozituar.

Në bazë të nenit 220, germa c, regjistrimi i bashkimit të shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit bën që shoqëria që përthithet të vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, pa kaluar në procesin e likuidimit.

Në bazë të nenit 155, germa g të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” Autoriteti i revokon licencën shoqërisë së sigurimit për të ushtruar veprimtari siguri nëse shoqëria e sigurimit prishet.

Për sa më sipër, Autoriteti,

V E N D O S I:

1. Revokimin e licencës së shoqërisë së sigurimit “Interalbanian Vienna Insurance Group” sh.a., për të ushtruar veprimtari sigurimi në Republikën e Shqipërisë.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI